

Ukë Xhema

RELIKTE TË KULTIT TË GJARPRIT NË TRADITËN POPULLORE SHQIPTARE

1. Hyrje

Kultura shpirtërore, e pjesërisht edhe ajo materiale-artistike e popullit shqiptar, bart në vete mbijetoja të religjionit primitiv-popullor. Ato, tanimë, na paraqiten si një substrat, shpesh i modifikuar me shtresime të mëvona që pasuan nëpër shekujt e së kaluarës së këtij populli. Në mesin e atyre shtresimeve hasen elemente të kulturave të huaja, të cilat, të gërshetuara me elementin mbizotërues së kulturës vendëse, nuk mbetën me karakteristikën e tyre burimore, veçse u shkrynë në pjesën më të madhe. Në këtë plan të ndikimeve reciproke kulturore, në arealin e ekumenës së caktuar, më së tepërmi u ndie në kulturën shpirtërore, përkatësisht mitologjinë popullore. Kjo edhe është e arsyeshme, ngase vetë niveli i zhvillimit ekonomiko-shoqëror, si i anasve, si i vërsuesve mbi këto troje (periudha e krishterimit, ortodoksizmit, myslimanizmit) ishte në atë shkallë të zhvillimit sa që çdo ndikim asimilues tentohej të bëhej në radhë të parë në planin fetar, nëpërmjet të cilit do kalohej në realizmin e pretendimeve të tjera territoriale e politike. Në anën tjetër, vetë evoluimi i kulturës popullore, e brenda saj i religjionit popullor, nëpërmjet zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomiko-shoqëror progresiv bëri që me arsye-tradita e vjetër të zëvendësohet me të rene, por pa humbur kontinuitetin e zhvillimit tradicional. Kështu që, çfarëdo çështje që të shtrohet, si në planin sinkronik, ashtu edhe atë diakronik, nga kultura popullore shqiptare ka kontinuitetin e vet të pashkëputshëm.

2. Gjarpri në mitologjinë popullore

Në kuadrin e mitologjisë popullore shqiptare, përkatësisht në strukturën e kulteve të ndryshme, kafshëve totemike i htonike, hyjnive, etj. gjarpri ka zënë vend pothuajse primar. Besimi në këtë kafshë htonike ishte aq i madh sa që arriti në kult. Paraardhësit e popullit shqiptar-Ilirët me besimin që kishin ndaj tij e konsideronin si

kafshë që simbolizon të mirën dhe të keqen.¹ Në kontinuitet historik ky besim arriti nëpër gjithë ata shekuj, edhe te shqiptarët. Ndërkaq, te të dytët na paraqitet shumë më i zbehtë. Megjithatë, në besimin popullor, veçanërisht të brezit të moshuar, në gjithë shqiptarët, ku më shumë e ku më pak, edhe sot gjejmë besimin për: „gjarprin rojë shtëpie”, „gjarprin rojë varri”, gjarprin në funksion të veprimeve magjike, si kafshë htonike, si kafshë totemike; si simbol i plleshmërisë në funksionin mashkullor; si kafshë flijuese dhe e murimit në themel të shtëpisë; si simbol i së damshmes-sidomos në kremtet e motmotit, festat kalendarike dhe si simbol i kultit të paraardhësve, krahas elementit të gërshetuar me kultin e diellit, i cili na duket se është nga më të zbehtit në gjithë besimet e tjera rreth tij.

Përveç besimeve të theksuara, tradita popullore në kulturën e vet materiale e artistike, ruan akoma edhe sot motivin e gjarprit. Ky motiv më së tepërmi është i prezentuar në tekstil, drugdhendje, veshje popullore, gurgdhendje, etj. Në formën plastike e me simbolikë të kafshës htonike, por më tepër në funksion apotropeik, e kemi hasur si aksesori në kostumin solemn të nuseve nga Drenica dhe treva e Medvegjës (fshati Sfirçë). Ndërkaq, pjesët e trupit të tij: lëkura ose „kmisha” e gjarprit, si e quan populli, dhëmbët, koka, unaza kurrizore, edhe sot e kësaj dite ndër shumë krahina etnografike, përdoren në disa veprime homeopatike magjike, për ta larguar të keqen, sëmundjen, mësyshin e që të sigurohet shëndeti, zhvillimi normal i fëmijëve, trashëgimi, etj.

Meqë qëllimi i këtij vështrimi është ndriçimi sadopak i relikteve rreth besimit të gjarprit në kulturën popullore sot, për hir të një kontinuiteti të zhvillimit historik, po përmendim disa nga shumë dëshmi që nxori në dritë shkenca e arkeologjisë rreth këtij problemi. Hulumtimet e gjertanishme ndër të tjera kanë vënë në pah besimin dhe respektin që i bënin ilirët gjarprit. Ata gjarprin e konsideronin si „të parin e fisit”, „stërgjysh”.² Kështu që më vonë filologë të shquar, si O. Gruppe, emrin e gjarprit e lidh me atë të ilirëve, etj.³ Megjithatë, kur është fjala për paraqitjet e gjarprit si dëshmi materiale e aspektit simbolik dhe të kultit, në këtë pjesë të Evropës, A. Stipçeviqi na del me mendim se këso paraqitjesh për këtë pjesë të botës pati para ilirëve, duke filluar që nga faza më e re e kohës së gurit, të cilat u gjetën në lokalitetin e Lepenski virit në Gjerdap.⁴ Vlen të përmenden edhe gjetjet e tjera të neoliti, me simbolikë gjarpri, që i nxorën në dritë gërmimet arkeologjike në „Tjerrtore” afër Prishtinës;⁵ pastaj ekzemplarë bylyzykësh, me koka gjar-

¹ Aleksandar Stipčević, *Kultni simboli kod Ilira*, Sarajevo 1981. f. 47.

² A. Stipçeviq, *po aty*, f. 48.

³ A. Stipçeviq, *po aty*, f. 53.

⁴ A. Stipçeviq, *po aty*, f. 48.

⁵ R. Galović, *Predionica*, Prishtinë, 1959, f. 25; A. Stipçeviq, *vepra e cituar*, f. 48.

pri, të kulturës së „Trebenishtit”, të gjetura te Kalaja e Hollmit afër Kolonje;⁶ një tjetër nga Selca e Poshtme,⁷ si dhe disa figura të tjera të gjarprit të periudhës helene, të gjetura në pllaka argjili nga Selca e Poshtme afër Pogradecit;⁸ pastaj ajo nga Krotina afër Beratit (Dimallumi antik).⁹

Pasojnë gjetjet e mëvona, si kulturë e „Mramorcit” me një areal shtrirjeje në Sërbi e Bosnjë e që i përkasin shekullit V. Nga këto gjetje po përmendim dy byzyzykë të gjetur në Pejë, nga më të bukurit të këtij lloji, me simbol të kokës së gjarprit.¹⁰ Të gjitha këto i përkasin punës, artit dhe besimit ilir.

3. Gjarpri në funksion apotropeik

Në popull, akoma ruhet besimi se, disa pjesë të trupit të gjarprit janë shëruese, ose shërbejnë si preventivë ndaj sëmundjeve të mundshme. Prej këndeje, jo rrallë herë vjen aplikimi i këtyre provave magjike, homeopatike, të cilat, sipas besimit të religjionit popullor, na dalin me karakter produktiv i cili gjithsesi është i paretalizueshëm. Shumë prej këtyre veprimeve lidhen që nga akti i lindjes së foshnjës, përkatësisht ndjekin ceremoninë e zakoneve familjare, që na bën të mendojmë për ceremoninë rituale të këtij besimi në një të kaluar. Kështu, foshnjës në djep ose pasi të fillojë të ecë, ia lidhin dhëmbin e gjarprit në djep, përkatësisht në flokë ose tasha të trupit,¹¹ krahas ceremonive e veprimeve të tjera me qëllim që atij fëmije t'i largohen të gjitha të „ligat”, magjitetë, sëmundjet dhe të zhvillohet normalisht e me shëndet të plotë. Pra, këtu kemi të bëjmë me funksionin apotropeik të gjarprit. Në analogji me këtë që theksuam, kemi hasur që unazat e palcës së kurrizit të gjarprit, të zbukuruar me disa penj ngjyrash të ndryshme, të punohet një lloj gjerdani, të cilin e bart nusja në qafë (fshati Mramur, Kosovë).¹² Pos funksionit apotropeik, që pa mëdyshje e luan prezencë e eshtrave të gjarprit në gjerdan, e të bajtura në trup nga nusja, na bën të mendojmë, përkatësisht të supozojmë, për një element të një besimi të lashtë, i cili nëpërmjet kësaj tradite do të na jetë përcjellë si survival i funksionit, përkatësisht personifikimit simbolik të gjarprit në rolin e mashkullit, e i cili do të shpiente te roli i gjarprit në plleshmërinë e gruas, rol ky që e luante gjarpri në besimin ilir.¹³

⁶ A. Stipçeviq, *vepra e cituar*, f. 50.

⁷ N. Ceka, *Studime historike*, 29, 1975, nr. 2, f. 160.

⁸ Shih në *Shqipëria arkeologjike*, Tiranë 1971, foto 47.

⁹ B. Dautaj, *Studia Albanica*, 2, 1965, nr. 1, f. 69; B. Dautaj, *Studime historike*, 19, 1965, nr. 2, f. 98; A. Stipçeviq, *vepra e cituar*, f. 50.

¹⁰ M. Garašanin, *Praistorija na tlu SR Srbije, II*, Beograd, 1973, str. 507.

¹¹ Informatore: Nole Metaj, amvise, Shushicë, KK Istog.

¹² Shënimi është marrur në fshatin Mramur, KK i Prishtinës, nga një amvise NN, e pa shkollë.

¹³ A. Stipçeviq, *vepra e cituar*, f. 58.

Edhe lëkura, përkatësisht „këmisha” e gjarprit, në besimin popullor ka një rol të caktuar. Atë përpos vendosjes nën shtrojë e në djep të fëmijëve, shpesh e bartin edhe të rriturit në trup. Qëllimi i kësaj është i karakterit dobiprurës, përkatësisht apotropeik. Më rëndësi është të përmendet veprimi magjik homeopatik me lëkurën e gjarprit që e bëjnë disa të rinj, duke marrë lëkurën dhe duke shiquar vajzën e cila u pëlqen më së tepërmi nga një pozitë ku askush nuk i dikton, me qëllim përvetësimi. Me këtë veprim homeopatik magjik synohet, sipas besimit, të arrihet gjer të njohja e dy të rinjve, çka në esencë flet për një relik të një besimi të lashtë, ku gjarpri paraqitet si element i plleshmërisë, po ashtu i mashkullit ndaj femrës. Për lëkurën e gjarprit, përkatësisht gjarprin në funksion simbolik të plleshmërisë, flet edhe një zakon tradicional, i ruajtur në medicinën popullore, në fshatrat e Moravës së Epërme, ku gjatë disa veprimeve tjera magjike për mundësimin e graviditetit, te gratë sterile, gruaja në fjalë gëlltit një pjesë të lëkurës së gjarprit, e cila më parë ka qenë e perzier me një therrë iriqi dhe ca gëzhoja veje.¹⁴

4. Gjarpri rojë shtëpie

Ky besim i lashtë, që nga koha ilire,¹⁵ në popullin shqiptar është njëri nga më të ruajturit. Për gjarprin rojë, shtëpie flasin me shumë besim, pothuajse gjithë shqiptarët, natyrisht të brezit të moshuar, anekënd. Ky gjarpër, sipas përshkrimit, në shumë treva, thuhet se dallon nga të tjerët me ngjyrën e trupit, në shpinë, pak më të zezë, më të mbyllët, që vend të përhershëm ka shtëpinë familjare. Ai lëviz nëpër çdo kthinë dhe pjesë të saj, i lirë. Nuk e ngacmon askush, por as ai nuk bën dëm, edhe pse shpeshherë ka rastisur të gjendet, nën jastek, dyshek ose të shtruar (mendohet kashte ose fieri), kryesisht ku gjenden fëmija e të mos e ketë helmuar askend. Këtë gjë, pra helmimin, ky gjarpër nuk e bën, nga se është rojë e shtëpisë, të cilin e konsideronin edhe anëtar familjeje.¹⁶ Gjarpri në funksion të mbrojtësit të anëtarëve të familjes ruhet mjaft mirë edhe sot, në besimin popullor. Ai (gjarpri) secilën natë (rethina e Gjilanit dhe Podgur të Pejës), përkatësisht çdo të shtatën natë (Drenicë), kalon mbi trupin e anëtarëve të familjes, pa e diktuar ata, nga se gjenden në gjum, në funksion të mbrojtësit. Secila shtëpi ka rojën e vet gjarpër, derisa nuk e mbyt. Nëse dikush e mbyt rojën e shtëpisë, sipas besimit të thellë popullor, në atë familje, e në radhë të parë atij personi, do t'i ndodhë një e keqe e madhe. Në traditën popullore gjithëherë thuhet se pozita e gjarprit rojë shtëpie është „katullaçë”. Pozitë kjo të cilën po e dëshmojnë edhe gërmimet arkeologjike, të cilat na

¹⁴ Informoi: Drita Halimi-Statovci, Prishtinë.

¹⁵ *Po aty*, f. 57.

¹⁶ Informoi: Fatë (Shala) Xhemaj, 80 vjeçare, amvise, Cërrolukë, KK Istog.

sjellin në dritë të dhëna për besimin dhe traditat e ilirëve sa i përket edhe gjarprit si rojë shtëpie. Edhe ky pra, është një element i cili vë në ndërlidhje traditën popullore prej të sotmes kah e kaluara e largët, prej të dytëve te të parët. Këso dëshmish, në Ballkan, ka relativisht shumë. Njërin nga më identikët e paraqet figura e gjarprit „kattullaçë” e gjetur në „Tjerrtore” afër Prishtinës, në një ambient shtëpiak, prej nga shifet edhe roli i gjarprit si shtazë kulturi.¹⁷ Kjo gjetje i përket kohës së neolitit.¹⁸ Rëndësi të posaçme ka për t’u përmendur paraqitja simbolike, në formën plastike, e gjarprit në gurgdhendje, mbi portën sekondare të hyrjes, në kullën e „pashës” në Pejë,¹⁹ pastaj mbi portën e hyrjes së kullën e Isuf Bajram Halitajt nga Tomoci-Podgur (shif foto 1. dhe 2.). Pos këtyre, gjarprin në formë plastike, të punuar, e të ruajtur në oda shtëpishë e hasim në shumë krahina etnografike të Kosovës, e veçmas në Drenicë e Rrafsh të Kosovës. Ndërkaq, mu në këto krahina, është traditë që me rastin e dhëndërrisë të theret një gjarpër dhe koka e tij të vendoset mbi trar të dhomës së bashkëshortëve. Ndoshtë që në vend të trupit të vëhet lëkura (Sankovc, Vasilevë-Drenicë), simbol ky i cili flet për kultin e gjarprit në funksionin e ruajtësit të vatrës familjare, i ruajtur gjer në traditën e sotme.

Vlen të përmendet, gjithashtu, se gjarpri, si rojë e vatrës familjare, është i përhapur në gjithë popujt indoevropjanë,²⁰ fakt ky i cili nuk e minimizon e as e vë në mëdyshje ekzistimin e këtij besimi të ilirët e as mbijetësimin si trashëgim te të dytët.

5. Gjarpri kafshë flijimi dhe murimi

Besojmë se shumë të rralla janë rastet, për të mos thënë nuk ekzistojnë, në traditën e ruajtur popullore shqiptare, ku e ndeshim gjarprin si kafshë flijimi, përkatësisht murimi në themele të shtëpisë. Një rast të tillë e kemi shënuar në terren në Podgur (në familjen e të ndjerit Metë Bajra, nga fshati Istog i Poshtëm, KK Istog-Kosovë).²¹ Pas hapjes së themeleve, para fillimit të murimit, të kullës së Bajrajve është zënë një gjarpër, të cilit ia kanë prer kokën dhe duke rrethuar themelin e shtëpisë, përkatësisht kullës së gurit, kanë bërë që gjaku i tij të pikojë rreth e përçark nëpër themel, për ta murosur më në fund në njërin kënd.

¹⁷ R. Galović, *vepra e cituar*, f. 25.

¹⁸ A. Stipčević, *po aty*, f. 57.

¹⁹ Kulla e Jashar Pashës në Pejë (monument historik) ku është mbajtur Mbledhja e Lidhjes së Pejës me 1899 e kryesuar nga Haxhi Zeka.

²⁰ A. Stipčević, *po aty*, f. 57.

²¹ Me rastin e ndërtimit të kullës në familjen e Bajrajve, është zënë një gjarpër dhe është therur në themel të kullës, gjaku i të cilit është shpërndarë rrethepërçark themelit, për t’u murosur më në fund në njërin kënd të tij. Shënimin e muarëm në një ekspeditë hulumtuese në terren, në këtë fshat në vitin 1978.

Flijimi i gjarprit, përkatësisht pikimi i gjakut në themelin e kullës, dhe më në fund murimi, në shenjë të „kurbanit” (element islamik), në shpjegimin popullor, ka të bëjë për mbarëvajtjen e gjithë familjes në atë vatër të re, si në planin shëndetsor, të shumimit dhe atë ekonomik e të harmonisë ndernjerzore. Gjersa gjarpri në rolin e kurbanit është marrë, sipas popullit, se është kurban i më i madh, është „bine” vetëm se nuk e shohin njerzit. Vërtet këtu kemi të bëjnë me një relikto të kultit të gjarprit ndaj kultit të paraardhësve. Gjaku i tij, përkatësisht trupi i murosur, personifikon ndërlidhjen e dy botave: të gjallëve me paraardhësit. Posaçërisht vlen theksuar relikto i një zakoni shumë të lashtë, i cili mbijetoi gjer në brezin e sotëm në Drenicë (fshati Vasilevë) e, që na kujton flijimin e kësaj kafshe htonkie me rastin e kremtimit të Shengjergjit, si festë agraro-blegtorale, e lidhur me ciklet vjetore të stinëve dhe kalendarin popullor. Këtu, mbajnë në kujtesë, kur me rastin e ditës së Shengjergjit therej gjarpri dhe në gojën e kokës së tij, të prerë nga trupi, vëhëj një thelb i hudrës i cili mbillej atë ditë në tokë. Sipas besimit popullor, koka e gjarprit do e ushqen hudren për t’u zhvilluar. Pastaj, thelbit e asaj hudre, që është zhvilluar dhe pjekur nga goja e gjarprit, nën dhé, i kanë baktë në trup gratë sterile, të cilat nuk lindnin fëmijë, në shenjë të rikthimit të graviditetit.

Funksioni simbolik i gjarprit, këtu, na del i shumfishtë. Flijimi i tij, ka të bëjë me kultin e paraardhësve, si formë e ndërlidhjes së jetës mbi tokë dhe asaj në amshim, duke simbolizuar pjellorin e tokës, përkatësisht hyjninë e pjellorisë, që lidhet përmes kësaj të kremteje agraro-blegtorale. Në anën tjetër, nëpërmes të hudres, pritet (sipas besimit popullor) të përcillet plleshmëria në gruan jo grvide. Ndërkaq, krahas relikto të besimit shumë të lashtë, i ruajtur si survival, në mënyrë kontinuitive ndërlidhet zakoni, gjithësesi më i ri e, i mbështetur në religjionin popullor, që në esencë është një veprim homeopatik-magjik, me karakter pozitiv-produktiv, si do thë shte Frezeri, që u ruajt me veprimin e hudrës për fitimin e graviditetit të grave.

6. Gjarpri rojë varri

Në krahasim me besimin popullor për gjarprin si „rojë shtëpie”, në funksionin e dytë, „gjarpri roje varri”, përkatësisht i të vdekurit, e hasim shumë më të zbehtë dhe më të rrallë. Në fshatin Shushicë, komuna e Istogut-Podgur, pohojnë se vërtet gjarpri është rojë varri dhe se, ka ndodhur kur shumë nga ky fshat e kanë parë duke i ruajtur varret e dy vajzave të vdekura nën unazë, e një familjeje nga ky fshat.²² Të njëjtin besim e ruajnë në shumë fshatra të Podgurit. Dhe shtojnë se pos gjarprit si rojë varri, është edhe „kali i

²² Informoi: Fekë Azllan Metaj, bujk. 85 vjeçar, nga lagja Metaj, fshati Shushicë, KK Istog.

varreve", zakonisht me ngjyrë të bardhë, dhe „ujku i varreve". Pohojnë gjithashtu se gjarprin e varreve, përkatësisht rojën e varreve, e kanë parë shpeshherë në varrezat e fshatit Saradran, komuna e Istogut-Podgor, për të cilin pohojnë se është shumë i madh.²³ Me rëndësi është të theksohet se, sipas besimit popullor, pozita e gjarp-rit roja varri gati gjithherë është „katullaç". Ky bën të mendojmë për trashëgiminë e besimit që nga lashtësia rreth kultit të gjarprit me kultin e të vdekurve dhe mënyrën simbolike të ruajtësit të nje-riut edhe pas vdekjes. Këtë besim e kishin mjaft të përhapur edhe ilirët,²⁴ çka u dëshmuar më vonë me shumë gjetje mbivarrore të ilirisë në kohën romake.²⁵

7. Gjarpri në disa ceremoni rituale të motmotit

Përveç vetive pozitive të gjarprit, në besimin popullor, ky simbolizon edhe të dëmshmen përkatësisht kafshën me veti të këqija. Në disa ceremoni rituale të të kremteve të motmotit, bëhen veprime imitative magjike, të cilat kanë për qëllim pengimin e të kë-qijave që eventualisht i kanosën personit, familjes ose bagëtisë, në vitin vijues agraro-blegtoral. Ato veprime shpesh paraqiten edhe me ceremoni të karakterit ritual, që na bejnë të mendojmë për gjur-mët e tyre në religjionin popullor-primitiv.

Kështu natën e ditës së verës, përkatësisht „verzës" në Opojë, plaka e shtëpisë merr një pe të kuq, dhe aty pranë vatrës fillon ta lidhë ne nyej. Pas çdo të lidhuri nyell, njëri nga djemtë e familjes i bën pyetje plakës vazhdimisht: ç'po ban ashtu moj gjyshe? ajo i përgjigjet: „po ja lidhi po ja cungoj (duke menduar në punët e kë-qija) gjarprit e gjarpërushes, bollës e bollushkës, minit e minu-shkës... për ditë t' parë, t'mar t'verzës". Lidhja e nyejve dhe „cun-gimi" magjik bëhet për secilin anëtar të familjes. Pas gjithë kësaj pune peni varet në „vargonjtë" e vatrës, e diku në tranin e mesëm të odës, dhe ndizet në zjarrin e vatrës. Me këto veprime imitative magjike, të cilat kanë qëllim purifikues, spastrues, ka për qëllim të ndërpriten të gjitha të këqijat eventuale që mund të lindnin eventua-lisht në vitin vijues. Pjesëmarrja e dy personave në ceremoni, përkatë-sisht e përfshirjes së gjithë anëtarëve në atë „lutje" magjike, flet për kolektivitetin e këtij veprimi magjik, ritual, i cili ka humbur në kohë, sikundër edhe shumë tradita.

Masoviteti ritual i ceremonisë shihet më i ruajtur në ditën e „Jeremisë", kur të rinj e të reja shpërndahen fushës me shkopinj në dorë duke imituar ndjekjen e gjarpërinjve nga fusha për t'i dërguar në Dri (Dri i Bardhë).

²³ Informoi: Nezir e Hasan Xhemaj, fshati Cërrollukë, KK. Istog.

²⁴ A. Stipçeviq, *po aty*, f. 57.

²⁵ *Po aty*, f. 57.

Për t'i dhënë karakter edhe më ritual, flasin vargjet e një kënge e cila këndohet me këtë rast:

„... *Jeremi, Jeremi*
bollë e gjarpër në Dri”

ose

„... *Jeremi Jeremi*
bollë e gjarpër në vrrri.”²⁶

Gjarpri këtu na del si kafshë me veti të këqija, i cili duhet të largohet nga fusha. Gjersa uji simbolizon elementin spastrues, i cili me lëvizje i largon të gjitha të këqijat.

8. Kult i diellit dhe gjarpri

Kulti i diellit në besimin popullor, paraqet njërin ndër kultet më të shënuara në mitologjinë shqiptare. Zakonisht është i lidhur me kultin e zjarreve. Ndërsa kulti i gjarprit me kultin e diellit në besimin popullor pothuajse nuk kanë gjurmë për një trajtim më të hollësishëm. Përpos një besimi të përgjithshëm se po e mbyte gjarpurin në mëngjes, ose në çfarëdo kohë tjetër të ditës, edhe nësa ia copëton trupin tërsisht nuk i „del” shpirti para perëndimit të diellit dhe, tërë kohën gjer atëherë i leviz çdo pjesë e trupit. Pra, në mënyrë simbolike është i lidhur shpirti i gjarprit me perëndimin e diellit.

9. Gjarpri simbol i plleshmërisë në personifikimin e mashkullit

Njëri ndër elementet më karakteristike, që na shpie te një besim i lashtë, është përvehtësimi i vajzës pas një shikimi nëpërmjet „këmishës” së gjarprit, nga ana e djalit, prej një pozite të padiktueshme nga askush. Ky veprim, në vetvete fshen një element magjik homeopatik, produktiv, por në esencë prapa tij qëndron besimi si relik i maskuar i gjarprit në funksionin e simbolit të plleshmërisë, si pjesëtar i gjinisë mashkullore.

Gjarpri, në funksionin e gjinisë mashkullore, të djalit, „të bukurit të dheut”,²⁷ na paraqitet edhe në shumë përralla popullore, si p.sh.: „Gjarpri dhe e bija e mbretit”, „Gjarpri, vajza dhe kuçedra”,²⁸

²⁶ Informoi: Hajri Nesimi, i lindur me 1943, pylltar, fshati Bresanë Opojë, 1978.

²⁷ A. Berisha, M. Mustafa, *Antologji e përrallës shqipe*, Prishtinë 1982, f. 43.

²⁸ *Po aty*, f. 58—64; Më gjersisht, shih: Demush Shala, *Martesa e gjarpërit në letërsinë popullore shqipe*, „Dituria”, 1. Prishtinë 1971, f. 93—106.

etj. Gjarpri, sidomos në përrallën e parë, në personifikimin e të bukurit të dheut, i atribuohen aftësi e fuqi mbinatyrore, i cili bën „transformime” rrënjësore në ambientin social, duke i zgjidhur problemet sociale shpejt e shpejt, por gjithherë duke përdorur unazën në funksionin e rrethit magjik.

Kalimi i tij gjatë nate në djal aq të bukur, saqë me bukurinë e tij mahnit gjininë njerëzore, të cilit nuk ngurrojnë ta konsiderojnë si: „njeri i jo kësaj bote!, por nga njerëzit e qiellit”,²⁹ e në rolin e burrit, të martuar me bijën e mbretit, jepet mundësia për krahasim të funksionit të gjarprit në plleshmërinë e gruas që kishte në besimin ilir.³⁰

Në të gjitha përrallat popullore të cilat kanë motiv martesën e gjarprit me grua, kemi të bëjë me elementin simbolik të plleshmërisë mashkullore.

10. Gjarpri si motiv dhe simbol

Në artin popullor, pa marrë parasysh ku është i paraqitur ai, në veshje popullore, drugdhendje, gurgdhendje, metal, tekstil, nëpër objekte, vegla, mjete ose instrumente popullore, etj., motivi i gjarprit zë një hapësirë shumë të madhe. Aq më i rëndësishëm është fakti, se, motivin e gjarprit në këtë plan, pos formave plastike-simbolike, pastaj atyre spiraleje, meandrike dhe valëzore, e hasim në format më primitive, më të vjetra të artit popullor, atij gjeometrik, të paraqitur me vija zig-zage dhe aso të thyera. Paraqitja e këtij arti motivor në ornamentikën popullore, i mbeti besnik traditës popullore të krijimit, persiatjeve të vlerave të trashëguara artistike e dekorative, por jashta vetëdijes për një paraqitje simbolike, pra, e kemi fjalën për motivet zig-zage, me vija të thyera, spiraleje, spirales së dyfishtë, etj.

Duhet veçuar prezentimin tradicional të disa aksesorëve në veshjet popullore, përkatësisht në kostumet solemne popullore të nuseve, të cilat ruajnë edhe sot e kësaj dite gjarprin në formën plastike të tij, në kuptimin simbolik. Prezenca e këtyre paraqitjeve simbolike në kostumet popullore të grave, flet më së qarti për jetësimin e kësaj tradite, ndoshta si survival i gjallë i asaj tradite të lashtë që nga antikiteti e gjer më sot. Po paraqesim një simbol të dy gjarpërinjve në një kostum nuseje nga krahina e Medvegjës, Sërbi, fshati Sfirçë.

Përndryshe, motivet me forma meandrike e spiraleje, që i ndeshim në artin dekorativ e ornamentik, në krijimet artistike popullore sot, shiquar në retrospektivë, gjurmët e tyre i hasim qysh në paleolitin e hershëm me funksion simbolik të gjarprit,³¹ e cila tra-

²⁹ A. Berisha, M. Mustafa, *vepra e cituar*, f. 43.

³⁰ A. Stipçević, *vepra e cituar*, f. 58.

³¹ *Po aty*, f. 50.



ditë vazhdon me një përdorim edhe më të theksuar në kohën e re të gurit³² dhe atë të hekurit,³³ e kështu me radhë.

Pra, duhet dalluar, siç është theksuar edhe më parë, se në krijimin artistik në fusha të ndryshme, motivi i gjarprit na paraqitet në dy funksione: 1. si motiv ornamentik i paqëllimtë, pra, jo simbolik, vetëm si traditë gati instiktive e që përsëritet me shekuj, 2. si simbol i gjarprit me veti apotropeike e htonike, në aksesoret e veshjeve popullore, kryesisht në veshjet e nuseve. Ndonëse funksioni i tij simbolik zbulon në vetvete gjithë ato besime të religjionit popullor.

Për simbolet dhe motivet e gjarprit në artin popullor në përgjithësi do të bëjmë fjalë më gjerësisht në një punim të veçantë.

Tek e fundit mbetet të konkludojmë se kulti i gjarprit në traditën e kulturës shpirtërore shqiptare, i shoqëruar me elemente shprehëse nga kultura materiale e artistike e popullit, ruajti, si rrallë ndonjë kult tjetër, gjurmët e atij religjioni popullor që nga ato kohë të mugëta të paganizmit.

³² *Po aty*, f. 11.

³³ *Po aty*.

Ukë Xhemaj

LE CULTE DU SERPENT DANS LA CULTURE POPULAIRE ALBANAISE

Résumé

Dans la culture spirituelle albanaise de nos jours encore on rencontre de nombreuses traces d'une religion primitive populaire. Ces restes parviennent à survivre malgré les influences religieuses plus tardives introduites par les cultures étrangères et les diverses confessions religieuses auxquelles elles appartenaient. Par conséquent au substrat de la religion populaire s'est ajouté un superstrat surtout chrétien et islamique.

Dans le cadre des traces d'une ancienne religion et de ses survivances nous distinguons les croyances concernant le culte du serpent. Chez les Illyres cet animal chthonique jouissait d'une grande vénération et croyance populaire en tant qu'ancêtre du clan, qui était à l'origine de la tribu. Cet animal totémique était le symbole du bien, du culte des ancêtres et de la fécondité, dans certains cas, plus rares, il symbolisait aussi le mal. Chez les albanais les mêmes croyances sont attachés au culte du serpent qui assure la continuité de la descendance et de la culture spirituelle.

Dans la croyance populaire le serpent est vénéré comme le gardien du foyer et de la tombe, l'animal aux vertus curatives et magiques qui apporte la santé. Nous le rencontrons aussi comme animal de sacrifice emmuré lors des fondations des maisons. Certaines cérémonies magiques utilisent l'une ou l'autre partie de son corps par exemple; s'emparer d'une jeune fille on la regarde à travers la peau d'un serpent; pour préserver le jeune couple du mal, de la magie et du mauvais oeil on place la tête du serpent sur l'une des poutres du plafond de la chambre des époux; pour protéger les bébés du mauvais oeil, des maladies ou de la magie on enfuit une dent ou la tête du serpent dans le berceau. On pend au cou des enfants plus grands les mêmes parties du serpent dans le même but; les jeunes mariées portent aussi des colliers faits avec les anneaux de la colonne vertébrale du serpent etc.

Le symbole du serpent en tant que force protectrice se retrouve dans les costumes populaires des jeunes mariées albanaises, spécialement dans le costume solennel soit sous la forme géométrique soit plastique.

Le motif du serpent est aussi présent dans la création artistique nous le trouvons brodé sur le tissu, sculpté dans le bois et la pierre sur les instruments de travail de musique et autres, il apparaît sous une forme géométrique, serpentine, spiralée et plastique.

Nous trouvons donc le serpent dans la culture matérielle et spirituelle soit comme symbole et avec la fonction d'animal chthonique, soit comme motif présenté instinctivement sans motivation précise au sujet de sa représentation symbolique et fonctionnelle.

The first part of the report is devoted to a general survey of the situation in the United States at the beginning of the century.

The second part of the report is devoted to a detailed study of the economic situation in the United States at the beginning of the century.

The third part of the report is devoted to a detailed study of the social situation in the United States at the beginning of the century.

The fourth part of the report is devoted to a detailed study of the political situation in the United States at the beginning of the century.

The fifth part of the report is devoted to a detailed study of the cultural situation in the United States at the beginning of the century.

The sixth part of the report is devoted to a detailed study of the religious situation in the United States at the beginning of the century.

The seventh part of the report is devoted to a detailed study of the educational situation in the United States at the beginning of the century.

The eighth part of the report is devoted to a detailed study of the scientific situation in the United States at the beginning of the century.

The ninth part of the report is devoted to a detailed study of the literary situation in the United States at the beginning of the century.

The tenth part of the report is devoted to a detailed study of the artistic situation in the United States at the beginning of the century.

The eleventh part of the report is devoted to a detailed study of the musical situation in the United States at the beginning of the century.

The twelfth part of the report is devoted to a detailed study of the theatrical situation in the United States at the beginning of the century.

The thirteenth part of the report is devoted to a detailed study of the cinematic situation in the United States at the beginning of the century.

The fourteenth part of the report is devoted to a detailed study of the radio situation in the United States at the beginning of the century.

The fifteenth part of the report is devoted to a detailed study of the television situation in the United States at the beginning of the century.

The sixteenth part of the report is devoted to a detailed study of the newspaper situation in the United States at the beginning of the century.

The seventeenth part of the report is devoted to a detailed study of the magazine situation in the United States at the beginning of the century.

The eighteenth part of the report is devoted to a detailed study of the book situation in the United States at the beginning of the century.

The nineteenth part of the report is devoted to a detailed study of the film situation in the United States at the beginning of the century.

The twentieth part of the report is devoted to a detailed study of the record situation in the United States at the beginning of the century.

The twenty-first part of the report is devoted to a detailed study of the television situation in the United States at the beginning of the century.

The twenty-second part of the report is devoted to a detailed study of the radio situation in the United States at the beginning of the century.

The twenty-third part of the report is devoted to a detailed study of the newspaper situation in the United States at the beginning of the century.

The twenty-fourth part of the report is devoted to a detailed study of the magazine situation in the United States at the beginning of the century.

The twenty-fifth part of the report is devoted to a detailed study of the book situation in the United States at the beginning of the century.